



Funded by  
the European Union



**IPLS** | institute for policy  
& legal studies



# PJESËMARRJA E KOMUNITETIT ROM DHE GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE MAJ 2025

## RAPORT MONITORIMI

IRCA | Qershor 2025

*Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e projektit “Pjesëmarrja e OShC-ve në proceset zgjedhore për një demokraci më të fortë dhe përshpejtimin e integritimit në BE”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore.*

*Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve financiar të tij, Bashkimi Evropian, ANTTARC dhe IPLS.*

## Përmbajtja

|                                                                                       |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Konteksti .....</b>                                                                | <b>3</b>  |
| <b>Qëllimi i raportit .....</b>                                                       | <b>4</b>  |
| <b>Metodologjia e Monitorimit.....</b>                                                | <b>5</b>  |
| Trajnimi dhe akreditimi i vëzhguesve .....                                            | 5         |
| Monitorimi i fushatës, programeve dhe aktivitetit të kandidatëve .....                | 5         |
| Vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve .....                                                  | 5         |
| Kërkesat për informacion .....                                                        | 6         |
| <b>Gjetjet Kryesore .....</b>                                                         | <b>6</b>  |
| Pjesëmarrja e komunitetit rom në zgjedhjet parlamentare .....                         | 6         |
| Përfaqësim i komunitetit rom në zgjedhjet parlamentare .....                          | 6         |
| Programet elektorale.....                                                             | 6         |
| Aksesi në informacion.....                                                            | 7         |
| Ndikimi mbi zgjedhësit.....                                                           | 7         |
| <b>Informimi i komunitetit rom dhe pakicave kombëtare mbi procesin zgjedhor .....</b> | <b>7</b>  |
| <b>Gjetje dhe problematika nga monitorimi në fushatën zgjedhore .....</b>             | <b>9</b>  |
| Incidentet dhe tensionet.....                                                         | 9         |
| Presioni dhe shit-blerja e votës.....                                                 | 10        |
| Fushata dhe programet.....                                                            | 10        |
| <b>Margjinalizimi dhe Diskriminimi .....</b>                                          | <b>11</b> |
| <b>Varfëria dhe Ndihma Ekonomike .....</b>                                            | <b>11</b> |
| <b>Probleme me Dokumentacionin .....</b>                                              | <b>11</b> |
| <b>Shpronësime dhe Dëbime .....</b>                                                   | <b>11</b> |
| <b>Kushtet e Jetesës.....</b>                                                         | <b>11</b> |
| <b>Diskriminimi në Arsim .....</b>                                                    | <b>11</b> |
| <b>Punësimi i Ulët:.....</b>                                                          | <b>11</b> |
| Kandidatët .....                                                                      | 13        |
| <b>Gjetje dhe problematika nga monitorimi në ditën e zgjedhjeve .....</b>             | <b>14</b> |
| Identifikimi në listat dhe qendrat e votimit.....                                     | 14        |
| Votimi familjar dhe fotografimi i votës.....                                          | 14        |

|                                                                            |    |
|----------------------------------------------------------------------------|----|
| Mungesa e aksesit .....                                                    | 16 |
| <b>Rekomandime</b> .....                                                   | 17 |
| Drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) .....                      | 17 |
| Drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Reformës Zgjedhore ..... | 18 |
| Drejtuar Partive Politike .....                                            | 18 |
| Drejtuar Medias dhe shoqërisë civile .....                                 | 18 |

## Konteksti

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e 1998-ës dhe Kodi Zgjedhor i 2008-ës, plotësuar me një sërë aktesh nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Shqipëria është palë në instrumentet ligjore ndërkombëtare të rëndësishme lidhur me zgjedhjet demokratike.



Zgjedhjet parlamentare të 11 majit u zhvilluan në një klimë politike tejet të polarizuar. Procesi i anëtarësimit në BE zuri vend dominues në diskursin politik, ku Partia Socialiste në pushtet bëri fushatë duke u përqendruar tek anëtarësimi në 2030-ën si objektivin e saj dhe duke vënë në dukje arritjet në procesin e negocimit, ndërkohë që partitë opozitare kritikuan përdorimin e retorikës së integritetit në BE si

mënyrë për të hequr vëmendjen nga problemet në vend, si standardi i jetesës, korrupsioni dhe hapat mbrapa në demokraci.

Realizimi për herë të parë i **votimit nga jashtë vendit** në këto zgjedhje u pa përgjithësisht si arritje e rëndësishme.

**Angazhimi politik i grave** është rritur vitet e fundit; megjithatë, ecja e tyre përpara vazhdon të pengohet nga barrierat e hershme në sistem, përfshirë edhe demokracinë e dobët brenda partive dhe mundësitë e kufizuara për financim. Gratë mbajnë gjysmën e posteve ministrore, por janë më pak të përfaqësuara në parlament, ku mbajnë 50 nga 140 vende gjithsej.

**Zgjedhjet** u administruan nga KQZ-ja, me 93 Komisione të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe 5,225 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi u bë në nivel qarku nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV) në 93 Qendra të Numërimit të Votave (QNV), një në secilën zonë, plus edhe një qendër për numërimin e votave nga jashtë vendit. KQZ-ja përbëhet nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet dhe Zëvendëskomisioneri, Komisioni Rregullator (KRR), si dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS).

Ashtu si edhe në zgjedhjet e mëparshme, **identifikimi biometrik i zgjedhësve** u përdor në të gjitha qendrat e votimit. Megjithëse shumica e zgjedhësve votuan në letër, votimi dhe numërimi elektronik i votave vazhdoi të pilotohet në dy zona.

---

<sup>1</sup><https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Kushtetuta-2017.pdf>

**Fushata zyrtare** filloi më 11 prill dhe vazhdoi deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Fushata ishte në përgjithësi e qetë, e fokusuar në aktivitete të vogla me pjesëmarrje fizike, vizita derë më derë dhe postime në rrjetet sociale.<sup>51</sup> PS-ja dhe PD-ja organizuan disa aktivitete më të mëdha, bashkë me një numër të kufizuar tubimesh nga partitë më të vogla. Disa nga çështjet që u ngritën gjatë fushatës përfshinin sigurimin e anëtarësimit në BE, zhvillimin ekonomik, luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e institucioneve demokratike. Toni i fushatës ishte shpesh konfrontues, me sulme personale midis dy partive kryesore dhe drejtuesve të tyre.

Gjatë fushatës u vërejtën disa pretendime për **shit-blerje votash** dhe në 37 raste nisi hetimi. Vëzhgues të OSCE - ODIHR ngritën pretendime për lidhje mes partive politike dhe krimin të organizuar në disa zona, intimidim dhe kërcënim nga ana e grupeve të krimin të organizuar ndaj zgjedhësve dhe, ndonjëherë, edhe ndaj kandidatëve.

## Qëllimi i raportit

Ky raport synon të paraqesë një analizë të thelluar mbi qasjen, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e komunitetit Rom dhe grupeve të tjera të marginalizuara në procesin zgjedhor të vitit 2025 në Shqipëri.

Duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare të monitorimit zgjedhor, të tilla si ato të përcaktuara nga OSBE/ODIHR dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, raporti vlerëson nëse janë garantuar të drejtat themelore të votës për këto grupe, në përputhje me angazhimet e Shqipërisë për respektimin e parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në demokraci.

Raporti ka për qëllim:

- **Vlerësimin e barrierave praktike, sociale dhe institucionale** që ndikojnë në ushtrimin e të drejtës së votës nga komuniteti Rom dhe grupet e tjera të marginalizuara.
- **Monitorimin e masave të ndërmarra nga institucionet publike**, veçanërisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të promovuar aksesin dhe informimin e këtyre komuniteteve në procesin zgjedhor.
- **Identifikimin e praktikave problematike** si blerja e votës, presioni ndaj votuesve, mungesa e informacionit në gjuhën e komunitetit, pengesat fizike dhe institucionale për pjesëmarrje të lirë dhe të barabartë.
- **Formulimin e rekomandimeve konkrete** për institucionet shtetërore, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim përmirësimin e

kushteve të pjesëmarrjes së komunitetit Rom dhe grupeve të marginalizuara në proceset zgjedhore të ardhshme.

## Metodologjia e Monitorimit

Procesi i monitorimit është ndërtuar mbi standardet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve, duke pasur si prioritet vlerësimin e aksesit dhe përfaqësimit të komunitetit Rom dhe grupeve të tjera të marginalizuara gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor.

### TRAJNIMI DHE AKREDITIMI I VËZHGUESVE



Në kuadër të këtij angazhimi, u zhvilluan trajnime të dedikuara për një grup prej 20 vëzhguesish, përfaqësues të komunitetit Rom dhe organizatës IRCA, të cilët u pajisën me njohuritë e nevojshme për të kryer monitorim të pavarur, të

paanshëm dhe në përputhje me ligjin zgjedhor shqiptar dhe angazhimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Vëzhguesit u pajisën me akreditimet zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke garantuar akses të plotë në procesin zgjedhor.

### MONITORIMI I FUSHATËS, PROGRAMEVE DHE AKTIVITETIT TË KANDIDATËVE

Monitorimi u shtri në të gjitha hallkat e procesit në Qarqet: Tiranë, Fier, Korçë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Berat duke filluar nga **periudha parazgjedhore**, ku u krye një analizë e programeve elektorale të partive politike me fokus vlerësimin e angazhimeve të tyre ndaj komunitetit Rom dhe grupeve të marginalizuara. Vëzhguesit monitoruan gjithashtu aktivitetet publike, fushatat sensibilizuese, takimet e kandidatëve me komunitetet në terren, si dhe prezencën e materialeve informuese në gjuhën rome.

### VËZHGIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit mbuluan procesin e votimit në qendrat e votimit me përqendrim të lartë të komunitetit Rom, duke evidentuar praktikat që pengonin ose lehtësonin ushtrimin e të drejtës së votës. Vëmendje e veçantë iu kushtua aksesit fizik në qendrat e votimit, rasteve të presionit, blerjes së votës, votimit në grup dhe incidenteve të tjera që ndikojnë në integritetin e votës së lirë.

## KËRKESAT PËR INFORMACION

Para dhe pas zgjedhjeve organizata IRCA i dërgoi kërkesa për informacion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me fushatën informuese për komunitetin rom dhe pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, si edhe partive politike lidhur me programet e tyre elektorale.

Të dhënat e mbledhura nga burimet e sipërcituara, u analizuan, u përpunuan u kryeqëzuan me raportin paraprake të OSCE – ODHIR dhe aktorëve të tjerë lokalë, dhe konkluduan në gjetje dhe rekomandime drejtuar institucioneve kyç në vend.

## Gjetjet Kryesore

### PJESËMARRJA E KOMUNITETIT ROM NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk analizoi ose publikoi të dhëna mbi pjesëmarrjen e komunitetit rom në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit e IRCA pjesëmarrja në votime kishte trend pozitiv, ishte e larmishme dhe e ndikuar nga faktorë lokalë, si niveli i mobilizimit apo kandidaturat për deputetë.

### PËRFAQËSIM I KOMUNITETIT ROM NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE

3 kandidatë nga komuniteti rom u përfshinë në listat për deputetë, por asnjëri nuk siguroi dot mandat parlamentar. Përfaqësimi mbeti simbolik dhe pa mbështetje elektorale të mjaftueshme edhe nga vetë përfaqësuesit e komunitetit. Kryeministri Rama premtoi pjesëmarrjen e mundshme të kandidatës Ina Majko në kabinetin e ri qeveritar, premtim që ka nevojë të mbikqyret në vijim.

Sipas raportit të OSCE - ODHIR sistemi zgjedhor aktual që e bën të detyrueshëm daljen me kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore, ishte pengesë për marrjen e mandateve në parlament nga ana e partive të pakicave kombëtare.

### PROGRAMET ELEKTORALE

Vetëm Lëvizja Bashkë ishte partia që ofroi një diagnozë të problematikave dhe solli premtime specifike për komunitetin rom.

Partia Socialiste promovoi më shumë kandidaten e komunitetit Rom sesa politikën për këtë komunitet, ndërsa partitë e tjera opozitare adresuan çështjen në mënyrë sporadike por jo të integruara specifikisht në programet e tyre.

## AKSESI NË INFORMACION

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatiti një fushatë informuese për pjesëtarët e komunitetit rom përpara zgjedhjeve. Pavarësisht se vlerësimi i vëzhguesve për nivelin e përgjithshëm të informimit ishte pozitiv, vetëm 25.9% e vëzhguesve raportuan prezencë të materialeve zgjedhore në gjuhën rome, ndërsa 74.1% konstatuan mungesën e tyre, duke treguar nevojën për përmirësim të aksesit në informacion mbi procedurat e votimit në të ardhmen.

## NDIKIMI MBI ZGJEDHËSIT

89.9% e vëzhguesve raportuan një situatë parazgjedhore të qetë dhe pa incidente, me vetëm disa raste të izoluara tensioni apo intimidimi, dhe disa votues të shoqëruar nga punonjës të administratës. Pati raportime specifike për përdorim të formave të tjera të ndikimit si organizimi i festave tradicionale nga kandidatë, ndërhyrje infrastrukturore apo shantazhi për ndihmën ekonomike.

## VOTIMI FAMILJAR DHE FOTOGRAFIMI I VOTËS

Fenomeni i votimit familjar është evidentuar në rreth 15% të rasteve të raportuara, kryesisht për shkak të vështirësive në lexim dhe shkrim nga votues të komunitetit rom që kërkonin ndihmë nga familjarët. Sa i përket fotografimit të votës, vetëm një rast është raportuar nga një vëzhgues pa detaje specifike. Në shumicën e rasteve, ndërhyrja e vëzhguesve dhe autoriteteve ka parandaluar shkeljen e rregullave të votimit të fshehtë.

## Informimi i komunitetit rom dhe pakicave kombëtare mbi procesin zgjedhor

Kushtetuta shqiptare parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat, dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur për të gjithë shtetasit shqiptarë pavarësisht nga origjina etnike, raca, besimi fetar apo gjuha.

Programi për edukimin e zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtare për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e kësaj kategorie zgjedhësish përgjatë periudhës zgjedhore.

Fokusi kryesor ku u shtri fushata informuese e KQZ për komunitetin Rom ishin: veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi

financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.<sup>2</sup>

Gjatë fushatës nuk u vunë re kufizime të përdorimit të gjuhëve të pakicave. Në fushatë nuk pati probleme të theksuara lidhur me pakicat kombëtare apo etninë dhe kandidatët e pakicave kombëtare shpesh bënë fushatë për çështje që prekin popullatën në tërësi, me përjashtim të një numri të vogël kandidatësh nga pakica greke që bënë fushatë lidhur me të drejtat e pronësisë.



Pakicat patën përgjithësisht mundësinë të merrnin pjesë lirisht si zgjedhës dhe si kandidatë, duke kandiduar si me dy partitë kryesore kombëtare, ashtu edhe me dy parti të pakicave kombëtare në koalicionin e udhëhequr nga PD-ja.

Sipas raportit të OSCE - ODIHR sistemi zgjedhor aktual që e bën të detyrueshëm daljen me kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore, ishte pengesë për marrjen e mandateve në parlament nga ana e partive të pakicave kombëtare. Ata gjithashtu theksuan se anëtarët e komunitetit rom ishin përgjithësisht të pafamiljarizuar me procedurat zgjedhore dhe se nuk kishte pasur ndonjë informim specifik për ta në këtë drejtim. Përveç kësaj, sipas ODIHR-it iu raportua edhe se ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane kishte pasur presion për shitje votash.


Bazuar në komunikimet me komunitetin dhe organzatat rome, shumica e vëzhguesve të angazhuar në këto zgjedhje përkatësisht 40.7%, e vlerësojnë nivelin e informimit me notën maksimale (5), ndërsa 33.3% e japin një vlerësim të mirë (4). Një pjesë më e vogël, 14.8%, e konsiderojnë mesatar (3), dhe vetëm 11.1% japin një vlerësim të ulët (2).

---

<sup>2</sup>[https://kqz.gov.al/media/documents/KQZ.EDUKIM.2025-PROGRAMI-EDUKIMIT\\_MINORITETET.pdf](https://kqz.gov.al/media/documents/KQZ.EDUKIM.2025-PROGRAMI-EDUKIMIT_MINORITETET.pdf)

Nuk është regjistruar asnjë vlerësim me notën minimale (1), çka tregon se, megjithëse ka ende hapësirë për përmirësim, perceptimi për nivelin e informimit është përgjithësisht i kënaqshëm dhe pozitiv.

Ndërkohë 74.1% e të vëzhguesve në terren deklarojnë se nuk ka pasur materiale të edukimit zgjedhor të afishuara në gjuhën Rome, duke evidentuar një mungesë serioze të informacionit të përshtatur për këtë komunitet. Vetëm 25.9% e tyre kanë konstatuar prezencën e materialeve në këtë gjuhë, çka nënvizon nevojën për përmirësim të aksesit në informacion. Materialet kanë qënë kryesisht te pasyqryara në qendrat komunitare ose shkollat publike.




## Gjetje dhe problematika nga monitorimi në fushatën zgjedhore

### INCIDENTET DHE TENSIONET

Për shumicën e vëzhguesve në terren (89.9%) situata politike parazgjedhore në zonat e aksesuara prej tyre ishte **e qetë dhe pa incidente të raportuara**. Vetëm 3.7% e tyre kanë pohuar se personat që janë lider të komuniteteve rome intimiduan votuesit, ndërkohë që 7% e vëzhguesve kanë identifikuar tensione të lehta në zonat elektorale.

Pjesa më e madhe e raportimeve nga vëzhguesit e IRCA konfirmojnë një proces të qetë dhe pa incidente, megjithëse pati raste kur votuesit ishin të painformuar për vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit, apo të shoqëruar nga nënpunës të administratës publike.



## PRESIONI DHE SHIT-BLERJA E VOTËS

Sipas vëzhguesve në disa raste janë përdorur forma alternative për të ndikuar votën e komuniteteve rom dhe egjiptiane, përveç ofertave direkte në para. Janë raportuar raste të organizimit të aktiviteteve sociale si festime të festave tradicionale para zgjedhjeve, ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturë si ndriçimi i rrugicave dy ditë para votimeve, si dhe përdorimi i presionit dhe shantazhit përmes kërcënimeve me heqjen e ndihmës ekonomike. Këto janë forma indirekte, por të qarta të ndikimit mbi vullnetin e votuesve.

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve raportojnë se nuk kanë konstatuar forma të tilla ndikimi në këto zgjedhje, duke theksuar se procesi ka qenë më i qetë dhe pa ndërhyrje të hapura në komunitet. Sipas tyre, krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, ka pasur më pak tentativa për blerje apo ndikim të votes. Gjithashtu nuk ka pasur asnjë rast të raportuar ku përfaqësuesit e partive politike, të mbledhin karta ID të anëtarëve të komunitetit rom, përpara ditës së votimeve.

## FUSHATA DHE PROGRAMET

Komunitetet rom dhe egjiptian janë ndër grupet më të marginalizuara dhe më pak të përfaqësuara në jetën publike dhe politike të Shqipërisë. Pavarësisht prezencës së tyre të konsiderueshme në vend, këto komunitete vijnë të përballen me barrierat e forta në përfshirjen institucionale dhe vendimmarrëse.<sup>3</sup>

Të dhënat e INSTAT tregojnë se romët dhe egjiptianët përbëjnë përkatësisht 12.4% dhe 9.8% të minoriteteve në Shqipëri. Megjithatë, përfaqësimi i tyre politik ka mbetur simbolik gjatë tri dekadave të pluralizmit, duke kulmuar vetëm në vitin 2019, kur Ervis Meçe arriti të zinte një mandat parlamentar në mënyrë zëvendësuese.<sup>4</sup>

<sup>3</sup><https://citizens.al/2025/05/06/premtime-ne-balte-jeta-e-komunitetit-rom-dhe-egjiptian-ne-skajet-e-politikes/>

<sup>4</sup><https://www.instat.gov.al/>



Lëvizja Bashkë është Partia e vetme e cila ka bërë një diagnozë të plotë të problematikave të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, e cila duhet të vlenë edhe për forcat e tjera politike si analizë nga ku mund të niseshin programet, por edhe premtime të dedikuara në program për këtë komunitet. Sipas Programit të

Lëvizjes Bashkë Komuniteti rom vuan këto problematika:

### **Margjinalizimi dhe Diskriminimi**

Romët dhe egjiptianët janë ndër komunitetet më të marginalizuara dhe të diskriminuara në Shqipëri.

### **Varfëria dhe Ndihma Ekonomike**

Rreth 11,000 qytetarë të këtyre komuniteteve përfitojnë ndihmë ekonomike, e konsideruar e pamjaftueshme.

### **Probleme me Dokumentacionin**

Mungesa e dokumenteve dhe analfabetizmi i pengojnë anëtarët e komunitetit të aplikojnë për ndihma dhe të gëzojnë të drejta ligjore.

### **Shpronësime dhe Dëbime**

Mungesa e dokumenteve për pronësinë i bën të pambrojtur ndaj shpronësimeve dhe dëbimeve për ndërtim kullash e veprash infrastrukturore.

### **Kushtet e Jetesës**

Vetëm 84% e komunitetit rom kanë akses në energji elektrike dhe 50% në ujë të pijshëm në banesat e tyre, krahasuar me 89% të fqinjëve jo-romë.

### **Diskriminimi në Arsim**

- 31% më pak fëmijë romë ndjekin arsimin parashkollor krahasuar me pjesën tjetër të shoqërisë.
- Vetëm 31% e fëmijëve romë ndjekin arsimin e detyrueshëm, kundrejt 66% të pjesës tjetër të shoqërisë.

### **Punësimi i Ulët:**

- Vetëm 22% e të rinjve romë (18-24 vjeç) janë të punësuar, ndjekin shkollën ose trajnim, kundrejt 58% të pjesës tjetër të shoqërisë.
- Punët e ofruara janë kryesisht të pakualifikuara, të vështira dhe të paqëndrueshme (p.sh. riciklimi i mbetjeve).

Dy premtimet kryesore që prekin specifikisht komunitetin Rom në programin e LB janë:

**1. Vendosja e Minimumit Jetik me Ligj:**

- Përcaktimi i minimumit jetik në nivelin 21,168 lekë.
- Rritja e ndihmës ekonomike dhe e pagesës së papunësisë në përputhje me këtë nivel.
- Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.

**2. Përmirësimi i Kushteve për Komunitetin Rom dhe Egjiptian:**

- Masa të posaçme për integrimin arsimor dhe në tregun e punës.
- Regjistrimi dhe pajisja me dokumente të të gjithë anëtarëve të këtij komuniteti.
- Njohja ligjore e pronës faktike për ta.
- Përmirësim i shërbimeve të strehimit social dhe ndërhyrje për përmirësimin e strehimit aktual.

Në këtë kontekst, sipas burimeve të monitorimit të komunikimeve publike dhe fushatave elektorale, “Lëvizja Bashkë” rezulton të jetë subjekti i vetëm që ka ofruar një program relativisht të plotë për komunitetet rom dhe egjiptian, megjithatë edhe ky program nuk përmban një trajtim të plotë e gjithëpërfshirës të të gjitha problematikave përkatëse.<sup>5</sup>



Nga ana tjetër, Partia Socialiste ka adresuar disa çështje që lidhen me këto komunitete gjatë fjalimeve publike, duke përmendur ofrimin e 3,500 bursave për nxënësit romë dhe egjiptianë si dhe kandidimin e zonjës Ina Majko – aktiviste e të drejtave të këtij komuniteti – në listat për deputete. Megjithatë, dokumenti programor zyrtar i

Partisë Socialiste për periudhën 2024–2030 nuk përmban një kapitull të posaçëm mbi politikat për komunitetet rom dhe egjiptian. Premtimi që mori vëmendjen e publikut dhe që përbën interes për t'u parë nëse do mbahet, ishte zotimi i Kryeminsitrit Rama në takimin elektoral në Korçë, për znj Ina Majko “Do japim më shumë bursa për fëmijë që vinë nga familje në ndihmë ekonomike dhe për shumë prej tyre që vinë nga familje egjiptiane dhe rome. Edhe unë jam shumë krenar që për herë të parë Partia Socialiste bëhet promotore e një kandidature nga komuniteti rom. Një vajzë nga Delvina, e cila përfaqëson vajzat e marginalizuara, por që jo vetëm mund të jetë një zë i nevojshëm në Kuvendin e Shqipërisë, por që edhe nëse nuk do të jetë në Kuvendin e Shqipërisë, patjetër që do të jetë një zë në qeverisjen tonë të mandatit të ardhshëm.”

<sup>5</sup> <https://levizjabashke.al/zgjedhjet-2025/programi/shteti-social/kujdesi-social/>

Partia Demokratike pavarësisht se kishte një paketë dhembshurie për shtresat sociale në nevojë, nuk ka bërë publik ndonjë program të dedikuar për komunitetet e marginalizuara, ndërsa subjektet e reja politike si “Mundësia” e z. Agron Shehaj dhe “Shqipëria Bëhet” e z. Adriatik Lapaj nuk përmbajnë asnjë referencë ndaj komuniteteve rom dhe egjiptian në dokumentet e tyre programore të publikuara në faqet zyrtare.

## KANDIDATËT

Analiza e listave të kandidatëve të partive politike për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 tregon një angazhim të kufizuar dhe kryesisht simbolik në përfshirjen e përfaqësuesve të pakices romë. Pavarësisht rëndësisë së përfaqësimit politik të këtyre komuniteteve, të dhënat e mbledhura tregojnë se **numri i kandidatëve nga pakica romë mbeti i ulët**, dhe asnjëri prej tyre nuk arriti të sigurojë **mandate parlamentare**.

- **Partia Socialiste (PS)**, si partia më e madhe në vend, përfshiu në listën e saj zgjedhore të qarkut Vlorë zonjën **Ina Majko**, përfaqësuese e minoritetit rom. Kandidatura e saj u promovua publikisht si një hap domethënës për përfaqësimin e këtij komuniteti. Megjithatë, rezultati i saj elektoral mbeti modest, me vetëm **338 vota** të siguruara në të gjithë qarkun, të pamjaftueshme për të fituar mandatin. Kryeministri ka deklaruar publikisht mundësinë e përfshirjes së saj në kabinetin qeveritar, një zhvillim që mbetet për t’u monitoruar pas konstituimit të Kuvendit.
- **Partia Social Demokrate (PSD)** përfshiu në listën e mbyllur të qarkut Fier znj. **Ardita Çela**, përfaqësuese e minoritetit rom. Megjithatë, në këtë qark PSD nuk arriti të fitojë asnjë mandat, duke marrë gjithsej vetëm **2,468 vota**.
- **Lëvizja Bashkë** përfshiu z. **Apostol Kosturi** në qarkun Korçë, me një rezultat prej **26 votash**.

**Informimi i komunitetit mbi kandidatët e komunitetit Rom:** Sipas vëzhguesve dhe lehtësuesve të komunitetit pjesëtarë të komunitetit rom kanë qenë **pjesërisht të informuar mbi kandidaturat romë** në zgjedhjet e fundit, veçanërisht për tre kandidatët në qarqet Fier, Vlorë dhe Korçë. Në disa zona, kjo është reflektuar në diskutime komunitare dhe opinione pozitive që inkurajonin përfshirjen e të rinjve romë në politikë.

Megjithatë, një pjesë e qytetarëve nuk kishin dijeni për ekzistencën e kandidatëve romë, ose kishin dëgjuar për ta, por nuk kishin ndërtuar besim për t’i votuar, duke i perceptuar si të lidhur me interesat e partive dhe jo me nevojat reale të komunitetit. **Mungesa e promovimit në media dhe fushatë ka ndikuar ndjeshëm në njohjen e tyre**, ndërsa në rrjetet sociale është konstatuar gjuhë diskriminuese, veçanërisht ndaj një kandidateje në qarkun Vlorë.

Gjithashtu, disa votues romë hasën **vështirësi në gjetjen e emrit në listat emërore** dhe orientimin në qendrën e votimit, gjë që e bëri procesin më të ndërlikuar për ta. Në zona të caktuara u vu re edhe **mungesë motivimi për të votuar**, për shkak të pakënaqësisë ndaj mungesës së shërbimeve bazë si strehimi dhe punësimi.

Të dhënat tregojnë se përfshirja e pakicave kombëtare në listat zgjedhore të partive politike në zgjedhjet e vitit 2025 ishte kryesisht në funksion të prezencës simbolike, pa një angazhim të dukshëm për të garantuar përfaqësim efektiv.

Ndonëse ka pasur raste të promovimit të kandidatëve nga pakicat, rezultatet zgjedhore tregojnë një mungesë mbështetjeje reale politike dhe elektorale për këto figura edhe nga vetë komuniteti, duke konfirmuar se **përfaqësimi politik i pakicave mbetet një sfidë e hapur për demokracinë përfaqësuese në Shqipëri dhe një hapësirë për tu rregulluar në të ardhmen.**

## **Gjetje dhe problematika nga monitorimi në ditën e zgjedhjeve**

### **IDENTIFIKIMI NË LISTAT DHE QENDRAT E VOTIMIT**


Megjithëse një problematikë e shprehur në zgjedhjet e kaluara, për shumicën e vëzhguesve në terren në zonat e mbuluara nga IRCA, nuk pati probleme të theksuara nga pjesëtarët e komunitetit rom në raport me listat dhe qendrat e votimit, përveç 2 – 3 rasteve sporadike të cilat kanë marrë zgjidhje me ndihmën e lehtësuesve të komunitetit dhe u është mundësuar e drejta e votës në qendrat e votimit ku rezultonin të regjistruar.

### **VOTIMI FAMILJAR DHE FOTOGRAFIMI I VOTËS**

Nga vëzhgimet e kryera, rezulton se fenomeni i votimit familjar ka qenë i kufizuar, duke u evidentuar në rreth 15% të rasteve të raportuara nga vëzhguesit, ndërsa në 85% të rasteve nuk është konstatuar një praktikë e tillë. Rastet e evidentuara lidhen kryesisht me vështirësitë në lexim dhe shkrim, veçanërisht tek anëtarët e komunitetit rom, të cilët kërkuar ndihmë për të lexuar fletën e votimit. Në disa raste, personat janë shoqëruar nga familjarët me pretendimin se nuk dinin të lexonin, por ndërhyrja e vëzhguesve dhe forcave të rendit ka parandaluar votimin në grup. Ndërsa lidhur me fotografimin e votës, vetëm njëri nga vëzhguesit ka pohuar për një rast, por pa pasur detaje specifike.

A vërejtët raste kur në dhomën e fshehtë futeshin më shumë se një person (Votimi “në grup” ose “familjar”)?

27 responses




Pavarësisht rasteve të izoluara, vëzhguesit raportojnë se në pjesën më të madhe të qendrave të votimit nuk është lejuar votimi familjar apo fotografimi i votës, dhe aty ku është konstatuar tentativë, është ndërhyrë në kohë për të respektuar rregullat e votimit të lirë dhe të fshehtë.

## PJESËMARRJA E KOMUNITETIT ROM NË KOMISIONE ZGJEDHORE DHE NË VOTIME

Bazuar në të dhënat e marra nga vëzhguesit në terren të organizatës IRCA, pjesëmarrja e komunitetit rom në zgjedhjet parlamentare është vlerësuar në mënyrë përgjithësisht positive. Ata kanë një vlerësim me një mesatare prej 3.85 për të rinjtë romë dhe 3.74 për komunitetin në përgjithësi, në një shkallë nga 1 në 5.

Në disa qendra votimi, pjesëmarrja e romëve ka qenë shumë e lartë, duke arritur deri në 100% deri në fund të ditës së votimit, ndërsa në disa raste u raportua fillimisht një pjesëmarrje më e ulët (rreth 20-50%), e cila më pas u rrit. Gjithashtu, ka pasur zona ku informacioni mbi pjesëmarrjen ishte i kufizuar ose mungonte plotësisht. Në disa zona zgjedhore në kryeqytet është raportuar një pjesëmarrje rreth 15% për komunitetin rom, ndërkohë që në disa qendra të tjera si ajo në njësinë 3289 u raportua një numër konkret prej rreth 65 votuesish romë.

Këto të dhëna tregojnë një pjesëmarrje të larmishme, të ndikuar nga faktorë lokalë, niveli i mobilizimit dhe prania fizike e komunitetit në vendbanimet përkatëse.



Lidhur me administrimin e procesit zgjedhor, grafiku më sipër tregon gjithashtu se 40.7% e qendrave të votimit të monitoruara kishin përfaqësues nga komuniteti rom në komisionin e votimit, ndërsa 59.3% nuk kishin asnjë përfaqësim. Kjo dëshmon se, megjithëse ka pasur përpjekje për përfshirjen e komunitetit rom në administrimin zgjedhor, përfaqësimi i tyre mbetet ende i ulët dhe i pabarabartë.

Mungesa e përfaqësuesve rom në shumicën e komisioneve kufizon ndikimin dhe përfshirjen aktive të komunitetit në procesin zgjedhor dhe mund të ndikojë në besueshmërinë dhe aksesin e barabartë në të gjitha hallkat e procesit.

### MUNGESA E AKSESIT

Të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit e IRCA tregojnë se vetëm 29.6% e qendrave të votimit ishin të përshtatura për lehtësimin e aksesit dhe lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara, ndërsa 70.4% e tyre nuk ofronin kushte të tilla, duke ngritur shqetësime për përjashtimin fizik të kësaj kategorie nga pjesëmarrja e barabartë.

Në disa raste specifike, u raportua se nuk ishte paraqitur asnjë person me aftësi të kufizuar, ndërsa në raste të tjera janë evidentuar individë me vështirësi të shikimit që kërkuan ndihmë nga familjarët për të lexuar fletën e votimit, dhe kjo u lehtësua me mirëkuptim nga komisionerët. Gjithashtu, u raportuan edhe raste të grave nga komuniteti që kishin nevojë për më shumë kohë për të identifikuar kandidatin, për shkak të vështirësive në lexim dhe kuptim, por procesi është zhvilluar pa incidente apo pengesa.

Këto të dhëna nënvizojnë mungesën e kushteve fizike dhe të informacionit të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke theksuar **nevojën për përmirësim në zgjedhjet e ardhshme.**

## Rekomandime

### DREJTUAR KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)

- Sigurimi i materialeve të informimit dhe edukimit zgjedhor në gjuhën rome në të gjitha zonat me përqendrim të lartë të komunitetit, minimalisht 1 muaj përpara zgjedhjeve dhe përdorimi i ndihmesave vizuale dhe përmbajtjes së thjeshtuar të përshtatura për individët me nivele më të ulëta të shkrim-leximit.
- Organizimi i trajnimeve praktike për mënyrën e votimit për grupet me nevoja të veçanta dhe përfaqësues të komunitetit, për një periudhë më të gjatë kohore, për të arritur një segment më të gjerë të popullsisë rome dhe për të siguruar një pjesëmarrje domethënëse.
- Trajnimet praktike duhet të synojnë jo vetëm të rinjtë dhe gratë nga pakica rome, por gjithashtu të angazhojnë individët në moshë të mesme dhe të moshuar, të cilët mund të përballen me pengesa më të mëdha në kuptimin e procesit të votimit.
- Votimi familjar vazhdon të jetë një shqetësim i rëndësishëm midis pakicës rome. Është thelbësore të ofrohet edukim i synuar për të gjithë anëtarët e rritur të familjes, duke theksuar se votimi është një e drejtë personale dhe private. Duhet të zhvillohen iniciativa pilot për të promovuar ndërgjegjësimin brenda familjeve rreth parimeve demokratike dhe për të forcuar mesazhin se 'vota i përket çdo individ'.
- Adresimi i barrierave administrative, si mungesa e dokumenteve të identifikimit (ID), është po aq i rëndësishëm sa edukimi zgjedhor, për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të komunitetit rom.
- Të krijohen mekanizma ligjorë dhe statistikore për të matur pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në zgjedhje.
- Të sigurohen ambiente të përshtatshme ose rrugë alternative votimi (si ai nëpërmjet postës) për persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuar në qendrat e votimit.

## DREJTUAR KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË REFORMËS ZGJEDHORE

- Miratimin e një kuote standarte përfaqësuese në kuvend dhe këshillat bashkiake për pakicat e komuniteteve rom dhe egjiptian, me qëllim sigurimin e përfaqësimit të interesave të komuniteteve drejtpërdrejt nga pjesëtarët e tyre.
- Shqyrtimi i formulës së përfaqësimit për të lejuar që partitë e pakicave kombëtare të konkurrojnë pa detyrimin për të dalë me kandidatë në të gjitha zonat elektorale.

## DREJTUAR PARTIVE POLITIKE

- Angazhimin e më shumë përfaqësuesve të komunitetit rom në listat e kandidatëve dhe në komisionet zgjedhore për të garantuar përfshirje reale.
- Adresim në kapituj specifik të problematikave të komunitetit rom në programet elektorale, të bazuara në konsultime publike.

## DREJTUAR MEDIAS DHE SHOQËRISË CIVILE

- Të rritet ndërgjegjësimi në komunitetet e marginalizuara për të raportuar presionet dhe të garantohet mbrojtje për denoncuesit.
- Të ndiqet dhe të mbikëqyret zbatimi i zotimeve politike, për të garantuar llogaridhënie publik.
- Ka një nevojë të ngutshme për të ndërtuar kapacitetin politik të liderëve të rinj nga komuniteti rom përmes krijimit të një Akademie Liderशिpi ose strukturave mbështetëse të ngjashme.